



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 123/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Xhevdet Abazi, kryesues, Rafet Haxhaj dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për apelin e Albulena Haxhiut, lidhur me tërheqjen nga lista si kandidatë për Anëtare të Kuvendit të Komunës së Podujevës, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 03.11.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 25.09.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET apeli si i palejueshëm i Albulena Haxhiut, Kandidate për Anëtare të Kuvendit të Komunës së Podujevës, nga subjekti politik AAK.

Arsyetim

Albulena Haxhiu, në cilësinë e kandidates për Anëtare të Kuvendit të Komunës së Podujevës, nga AAK, ka parashtruar apel në PZAP, me datën 25.09.2013, për tërheqje nga lista për anëtare të Kuvendit Komunal në Podujevë, ku parashtruesja e apelit thekson se tërheqjen nga subjekti politik e bën për shkaqe personale.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i gjeti se apeli është i **palejuar**:

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me LZP konkretisht me nenin 28.1 të LZP-së, ku dispozitat ligjore përcaktojnë që subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit.

KQZ-ja me datën 19.09.2013, e ka hedhur shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotime për Zgjedhjet Lokale të datës 03.09.2013. Andaj pala e cila ka parashtruar apel në PZAP nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e kërkesës për tërheqje në KQZ sipas nenit 28.5 të LZP-së. Me qenë se pala ankuese nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e lartcekur për tërheqje nga lista e kandidatëve por ka parashtruar drejtpërdrejt apel në PZAP, gjë që nuk është e lejuar sipas LZP-së, PZAP-i, vendosi se apeli është i palejuar prandaj duke u bazuar në nenin 9.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 123/2013 më datën 25.09.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*